



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 348 Prot.

Tiranë, më 19.03.2018

### V E N D I M

Nr.15, Datë 19/03/2018

#### **PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE, BASHKIA DIVJAKË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Divjakë,

#### **VËREJ SE:**

Me Vendimin nr. 214, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Lushnje dhe Divjakë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Divjakë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 1727/1 prot., datë 25.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili, me shkresën nr. 1727/2 prot., datë 25.10.2017, “*Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Divjakë*”, i është njoftuar Bashkisë Divjakë.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 1727/5 prot., datë 23.1.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Divjakë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 259/1 prot., datë 7.2.2018, “*Kthim përgjigje*”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, së bashku me observacionet përkatëse në lidhje me konstatimet e grupit të mbikëqyrjes.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 259/2, datë 8.2.2018, “*Observacion*”, bashkëlidhur shkresës përcjellëse, nga ana e institucionit, është kërkuar që, pozicioni i punës “*Administrator shoqëror*”, të vazhdojë të mbetet jashtë fushës së shërbimit civil me pretendimin se, në ligjin nr.121/2016, “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”, hasim emërtimin “*punonjës i shërbimeve sociale*”, i cili, nisur nga kjo emërtesë, nuk është pjesë e shërbimit civil.

Pretendimet e parashtruara nga Bashkia Divjakë, sikurse është analizuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, nuk qëndrojnë. Pozicioni i punës “*Administrator shoqëror*”, konsiderohet pjesë e shërbimit civil dhe si i tillë, ai do të trajtohet sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil, si dhe në përputhje me kërkesat specifike të funksionimit të këtij pozicioni pune.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

## Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Divjakë dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Sektori i Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, gjatë përgatitjes dhe propozimit të strukturës organizative të institucionit, të saktësojë emërtesat e pozicioneve të punës që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, si dhe të përcaktojë qartë raportin e pozicioneve të punës me shërbimin civil, me qëllim krijimin e kushteve për administrimin e shërbimit civil në vijimësi, në përputhje me ligjin. Këto veprime të kryhen duke u bazuar në orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.
3. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Divjakë, që të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullohen pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe atë financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas gjeneraliteteve, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist Audit”, akti nr.45, datë 8.6.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit”, akti nr.2, datë 6.1.2015.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist Finance”, akti nr.265, datë 18.7.2015.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist Finance” në Njësinë Administrative Grabian, akti nr.70, datë 20.2.2017.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror”, akti nr.119/1, datë 21.3.2017.

- ✓ \*\*\*\*\* , “Administrator Shoqëror”, Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror, akti nr.117, datë 1.9.2014.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Administrator Shoqëror” në Njësinë Administrative Tërbuf, akti nr.36, datë 18.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Administrator Shoqëror” në Njësinë Administrative Remas, akti nr.16, datë 7.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Administrator Shoqëror” në Njësinë Administrative Gradisht, akti nr.261, datë 10.7.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inxhinier”, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, akti nr.58, datë 2.4.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Shef i Sektorit të Projekteve dhe Investimeve”, akti nr.259/1, datë 5.9.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i Kontrollit të Projekteve dhe Investimeve”, akti nr.83/1, datë 7.3.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i Kontrollit të Projekteve dhe Investimeve”, akti nr.4, datë 24.3.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore”, akti nr.162, datë 26.11.2014.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Inspektor Taksash” në Njësinë Administrative Remas, akti nr.166, datë 14.4.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, Sektori Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Protokoll/Arkiva, akti nr.37, datë 18.5.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist IT”, Sektori Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Protokoll/Arkiva, akti nr.79, datë 7.11.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Protokollist”, Sektori Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Protokoll/Arkiva, akti nr.41, datë 30.5.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Arkivist”, Sektori Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Protokoll/Arkiva, akti nr.18/2, datë 2.2.2015.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Agronom”, Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes, akti nr.78/2, datë 13.1.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Agronom”, Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes, akti nr.16/1, datë 7.4.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Veteriner”, Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes, akti nr.78/4, datë 4.3.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Veteriner”, Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes, akti nr.13/1, datë 18.1.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist Statistike”, Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes, akti nr.106, datë 28.12.2016.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit dhe Pyjeve”, akti nr.89/1, datë 1.3.2017.
- ✓ \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Tokës”, kontratë datë 16.11.2016.

- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor*”, Sektori i Menaxhimit të Tokës, akti nr.50, datë 20.6.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor*”, Sektori i Menaxhimit të Tokës, akti nr.32, datë 9.5.2016.  
\*\*\*\*\*, “*Topograf*”, Sektori i Menaxhimit të Tokës, akti nr.60, datë 4.7.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Topograf*”, Sektori i Menaxhimit të Tokës, akti nr.155, datë 11.4.2017.
- Njësia përgjegjëse, të planifikojë zhvillimin e procedurës së rekrutimit, me qëllim që ndërprerja e marrëdhënieve të punës, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke e ndarë procesin e rregullimit të ligjshmërisë në dy faza, për shkak të numrit të lartë të pozicioneve të punës të plotësuar në kundërshtim me ligjin, me qëllim që të mos pengohet veprimtaria në funksionimin e institucionit dhe shërbimit ndaj qytetarit.
- Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2018, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.
- Njësia përgjegjëse, të fillojë procesin e rekrutimit për pozicionet e lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në kreun IV, “*Pranimi në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.
4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, për pozicionin e punës “*administrator shoqëror*”, evidentuar në 5 raste në strukturën e institucionit, të saktësojë emërtesën e këtij pozicioni pune si “*Specialist i shërbimeve sociale*”, i cili konsiderohet pjesë e shërbimit civil dhe të hartojë përshkrimin e punës në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil. Më tej, të plotësojë pozicionet e punës, në përputhje me procedurat e konkurrimit, të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, në zbatim të nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr.116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e*

*nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “nëpunës civil”, në pozicionin “Administrator shoqëror”, në Njësinë Administrative Grabian.*

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të fillojë procedurën për përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësin \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr.260, datë 10.7.2017, të titullarit të institucionit, në pozicionin e punës “Inspektor taksash”, në Njësinë Administrative Gradisht, i cili nuk ka një diplomë të arsimit të lartë (arsim i mesëm), e për këtë shkak, nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor që duhet të ketë nëpunësi në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil ku është emëruar, sipas pikës 6, të Vendimit nr.116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
7. Për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me rastet e ngritjes në detyrë në kundërshtim me ligjin, Kryetari i Bashkisë Divjakë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për secilin punonjës të evidentuar në vijim sipas gjeneraliteteve, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Përgjegjës Auditit”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, akti nr.48/4, datë 1.3.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Shef i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike”, akti nr. 122/2, datë 4.4.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Protokoll/Arkiva”, akti nr.49/1, datë 1.3.2016.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes”, akti nr. 78/3, datë 4.3.2016.
  - Punonjësit të rikthehen në pozicionet e mëparshme të punës, ku kanë qenë në momentin e transferimit. Në rastet e pamundësisë për t’u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, të bëhet sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, ku ata i plotësojnë kërkesat specifike për vendin e punës.
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Divjakë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

- 10.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
- 11.** Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Divjakë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**